REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:065042

Datë: 23.04.2021

Numri i dokumentit: 01726541

PKR.NR.127/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me gjyqtaren Violeta Husaj-Rugova me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësore Dafina Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit S. B. nga K. ..... me banim në fsh. ....., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.2181/18 të dt.30.10.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencë të Prokurorit të shtetit Haxhi Sinanaj, të akuzuarit S. B. mbrojtësit të tij sipas autorizimit V. B., me dt. 19.04.2021 mori, dhe me dt.23.04.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

S. B. , i biri i J. dhe nenës H. e gjinisë R., i lindur me dt. ..... ne fshatin ..... K-....., ku dhe jeton, i martuar, babë i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën mesme , bujk, posedon nr. tele. ..... , i gjendjes së dobët ekonomike, nr. personal ....., shqiptar, Shtetas i R. së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më parë e gjerë me dt. 21.10.2018, pikërisht në shtëpinë e tij në fsh ....., në kundërshtim me nenin 5 par 1 të Ligjit për Armë(Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll armë zjarri, në atë mënyrë që ditën kritike gjatë bastisjes nga ana e policisë, të njëjtit iu është konfiskuar një pistoletë " Zastava" e kalibrit 6.35mm, me nr. serik T742021 dhe 6 fishek të të njëjtit kalibër.

Me çka ka kryer vepër penale, mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së

Andaj , gjykata konform nenit 7,41,43,46,73,, dhe nenit 374 par.1. të KP të Kosovës 365 dhe 233 të KPP të Kosovës, të akuzuarit i shqipton :

2018:065911

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit S. B. i cakton dënim me gjobë në lartësi prej 400€ (katërqind euro) , të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 3(tre)muajsh, nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari i lartcekur dënimin nuk e paguan në afat të caktuar ,atëherë dënimin me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu , duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 (njëzetë) euro të gjobës.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 15€ (pesëmbëdhjetë euro) , si dhe shumën 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të viktimave, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë)ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të akuzuarit i konfiskohet një pistoletë " Zastava" e kalibrit 6.35mm, me nr. serik T742021 dhe 6 fishek të të njëjtit kalibër, dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të shkatërrohen. Të njëjtat gjinden në zingjirin e ruajtjes pranë stacionit Policorë në Pejë nën numrin 2018-DA-2160.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.2181/18 të dt.20.10.2018, kundër të akuzuarit S. B. nga fsh. ..... K-....., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Në Prokurorin themelore në Pejë Departamentin e përgjithshëm është arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë PP?II.nr.2181/18 me dt. 30.10.2018, në mesë të prokurorisë, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. F. H.. Me dt.06.11.2018 marrëveshjen e arritur bashke me aktakuzë ia dorëzon gjykatës.

Lënda bazuar në dispozitën e nenit 22 të KPPRK-së nga departamenti i përgjithshëm është transferuar në departamentin për krime të rënda ku dhe gjykata ka caktuar seancën për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë me dt.19.04.2021. para mbajtjes së seancës i akuzuari ka sjell autorizimin me të cilin ka autorizuar avokatin V. B. sipas autorizimit.

Në seancën për shqyrtimin e marrëveshjes janë prezantuar prokurori i shtetit Haxhi Sinanaj, i akuzuari S. B. dhe mbrojtësi i tij av.V. B. është bërë e ditur përkatësisht është konfirmuar se: i akuzuari, mbrojtësja e tij av.F. H. sipas detyrës zyrtare dhe prokurori i shtetit me dt. 30.10.2018 kanë lidhë marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe të njëjtën marrëveshje sërish e kanë konfirmuar edhe në shqyrtimin gjyqësor dhe kanë mbetur pranë të njëjtës. Këtë marrëveshje gjyqtarja e ka pranuar – e bindur thellë se marrëveshja e tillë është bërë konform dispozitave të Kodit të procedurës Penale dhe të Kodit Penal të Republikës së Kosovës .

Pasi që u aprovua përkatësisht u pranua marrëveshja mbi pranimin e fajësisë gjyqtarja e konfirmoj edhe vendimin mbi dënimin ashtu siç është arritur edhe në marrëveshjen për pranimin e fajësisë.

2018:065911

Konform nenit 374 par.3 të KPRK-së u mor vendimi mbi konfiskim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në nenin 450 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarin në shpenzimeve të procedurës penale.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarin që të paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,

2018:065042, 23.04.2021

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

2018:065911